

Zhvillimet e fundit ndërkombëtare për barazinë gjinore në zgjedhje

Detyrimet e Shqipërisë për pjesëmarrjen politike të grave rrjedhin nga një sërë standardesh ndërkombëtare, përfshirë Konventën për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave (CEDAW) që mbështet të drejtën e grave për të marrë pjesë në jetën publike, dhe Platformën për Veprim të Pekinit, e cila bën thirrje për eliminimin e të gjitha barrierave për pjesëmarrje të barabartë. Gjithashtu, nëpërmjet Objektivit 5 të Zhvillimit të Qëndrueshëm, Shtetet kanë marrë përsipër “arritjen e barazisë gjinore dhe fuqizimin e të gjitha grave dhe vajzave”, ç’ka kërkon të “sigurohet pjesëmarrja e plotë dhe efektive e grave dhe mundësi të barabarta për udhëheqje në të gjitha nivelet e vendimmarrjes në politikë, ekonomike dhe jeta publike” (objektivi 5.5.). Treguesit përfshijnë "proporcionin e vendeve të mbajtura nga gratë në parlamentet kombëtare dhe qeveritë vendore" (5.5.1.) dhe "proporcionin e grave në pozicione drejtuese".

Komiteti CEDAW, organi i ngarkuar ndër të tjera, për interpretimin e dispozitave të Konventës CEDAW nxjerr Rekomandime të Përgjithshme. Komiteti nxori Rekomandimin e tij të parë të Përgjithshëm mbi Pjesëmarrjen e Grave në Politikë, Nr.23 (1997), i cili është përditësuar së fundmi nëpërmjet Rekomandimit të Përgjithshëm Nr.40 (2024) mbi përfaqësimin e barabartë dhe gjithëpërfshirës të grave në sistemet vendimmarrëse. Komiteti ofron udhëzime gjithëpërfshirëse për shtetet për arritjen e përfaqësimit të barabartë dhe gjithëpërfshirës të grave në të gjitha sistemet vendimmarrëse në të gjithë sektorët, duke synuar një ndryshim sistematik. Ai përshkruan masat legislative, politike dhe programore për të siguruar zbatimin e këtij detyrimi dhe për të kapërcyer sfidat globale. Ky dokument përkufizon "përfaqësimin e barabartë dhe gjithëpërfshirës" si barazi pesëdhjetë e pesëdhjetë midis grave dhe burrave në të gjithë diversitetin e tyre për sa i përket aksesit të barabartë dhe fuqisë së barabartë brenda sistemeve vendimmarrëse.

Për këtë qëllim, Komiteti identifikon shtatë shtylla të përfaqësimit të barabartë dhe gjithëpërfshirës në sistemet vendimmarrëse: (a) barazi pesëdhjetë e pesëdhjetë midis grave dhe burrave në sistemet vendimmarrëse si pikënisje dhe normë universale; (b) përfshirjen e rinisë në udhëheqje e kushtëzuar nga barazia gjinore; (c) ndërsektorialiteti (ndërlidhja e gjinisë me faktorë të tjerë si etnia, aftësia e kufizuar) dhe përfshirja e grave në të gjithë diversitetin e tyre në sistemet vendimmarrëse; (d) një qasje gjithëpërfshirëse ndaj sistemeve vendimmarrëse në të gjithë sferat; (e) pushtet dhe ndikim të barabartë të ushtruar nga gratë në sistemet vendimmarrëse; (f) transformimi strukturor për përfaqësimin e barabartë dhe gjithëpërfshirës të grave në sistemet vendimmarrëse; dhe (g) përfaqësimi i shoqërisë civile në sistemet vendimmarrëse.

Burimi: KQZ/UNWomen. Informacion paraprak mbi proceset zgjedhore në Shqipëri